



UDHËZIME PËR PËRDORIMIN ETIK TË INTELIGJENCËS ARTIFICIALE NË MEDIAN SHQIPTARE

HYRJE

Përdorimi i Inteligjencës Artificiale (IA) në media po transformon mënyrën se si prodhohen dhe shpërndahen lajmet. Megjithatë, ky zhvillim ngre çështje etike që kërkojnë adresim të kujdesshëm për të ruajtur integritetin dhe besueshmërinë e gazetarisë. Këto teknologji të reja kanë potencialin të rrisin dhe forcojnë rolin social të medias, por vetëm nëse përdoren në mënyrë transparente, të drejtë dhe të përgjegjshme, duke respektuar dhe promovuar vlerat thelbësore të etikës gazetareske. Këto udhëzime synojnë të ofrojnë një kornizë për përdorimin etik të IA-së në mediat shqiptare, duke u bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare dhe parimet e Kodit të Etikës. Inovacioni teknologjik duhet të shërbejë për të fuqizuar median dhe gazetarët në përmbushjen e misionit të tyre për të ofruar informacion cilësor dhe të besueshëm.

ÇFARË ËSHTË INTELIGJENCA ARTIFICIALE DHE CILAT JANË DISA NGA MËNYRAT E PËRDORIMIT NË MEDIA?

Inteligjenca Artificiale (IA) është një fushë e shkencave kompjuterike që krijon sisteme të afta për të kryer detyra, të cilat zakonisht kërkojnë inteligjencë njerëzore. IA përfshin algoritme dhe modele të sofistikuar, të cilat mund të analizojnë të dhëna në sasi të mëdha, të nxjerrin përfundime dhe të ofrojnë rekomandime në kohë reale.

Në kontekstin e medias, Inteligenca Artificiale mund të përmirësojë efikasitetin dhe saktësinë e raportimit të lajmeve, të personalizojë përmbajtjen për audiencat dhe të ndihmojë në luftën kundër dezinformimit. Gazetarët dhe redaktorët mund ta

përdorin Inteligjencën Artificiale për përpunuar, analizuar informacionin në mënyrë të automatizuar dhe për të parashikuar tendencat e lexuesve në kohë reale. Kjo do t'i ndihmojë ata të reduktojnë ngarkesën e punës, por edhe të përdorin sistemet e automatizuara në formën e një asistenti personal që i bën të kuptojnë më mirë preferencat e audiencës.

IA gjenerative përbën një kategori të avancuar të kësaj teknologjie, e cila mund të krijojë përmbajtje të re në formën e teksteve, imazheve, audiove dhe videove, bazuar në të dhëna të mëparshme.

Aplikacione të inteligjencës artificiale përdoren gjerësisht për analizimin dhe interpretimin e sasive të mëdha të të dhënave për të nxjerrë përfundime të vlefshme. Kjo ndihmon gazetarët në përdorimin efikas të të dhënave që lidhen me zbulimin e temave më të pëlqyera, vlerësimin e reagimeve të audiencës ndaj përmbajtjes dhe identifikimin e lajmeve të rreme.

Inteligjenca Artificiale mund të ndihmojë në identifikimin e lajmeve të rreme ose të manipuluar duke kryqëzuar në kohë rekord burime të shumta dhe duke analizuar autenticitetin e përmbajtjes. Përdorimi i një kapaciteti të tillë të Inteligjencës Artificiale bëhet veçanërisht i rëndësishëm në një epokë si kjo e tanishmja ku lajmi i rremë mund të përhapet shumë shpejt.

Inteligjenca Artificiale gjithashtu ndihmon në automatizimin e proceseve redaktuese, duke identifikuar dhe kategorizuar përmbajtjen sipas temave, identifikuar gabimet gjuhësore dhe përzgjedhur në mënyrë automatike materiale të përshtatshme për publikim.

PARIMET BAZË PËR PËRDORIMIN E IA-SË NË MEDIA

Përdorimi etik i Inteligjencës Artificiale në mediat shqiptare duhet të bazohet në tre parime bazë: **ruajtja e besimit të audiencave te media; përdorimi i teknologjisë nën mbikëqyrjen njerëzore dhe sigurimi i transparencës.** Me zbatimin e këtyre udhëzimeve, media dhe gazetarët shqiptarë mund të përfitojnë nga Inteligjenca Artificiale duke i qëndruar besnik misionit për informimin e saktë dhe paanshëm të audiencave.

1. Përdorimi i Inteligjencës Artificiale nuk duhet të minojë besimin e audiencave te media.

Besimi i audiencës është themeli i gazetarisë cilësore dhe të pavarur. Përdorimi i Inteligjencës Artificiale mbështetet në parimin se informacioni duhet të respektojë të gjitha standardet etike dhe deontologjike të gazetarisë, të cilat shërbejnë si garanci për besimin e audiencave.

- Redaksitë e medias dhe gazetarët duhet të jenë të vetëdijshëm për kufizimet, mundësitë, por edhe rreziqet që mbart inteligenca artificiale, si dhe të mos mbështeten plotësisht në të gjatë punës së tyre në mbulimin e ngjarjeve.

- Inteligjenca artificiale mund të prodhojë përmbajtje të pasaktë, të manipuluar dhe të njëanshme. Për këtë arsye, çdo informacion duhet të verifikohet nga gazetarët dhe drejtuesit e redaksive përpara publikimit.
- Inteligjenca Artificiale duhet të përdoret si një mjet mbështetës për gazetarët dhe jo për të zëvendësuar raportimin investigativ dhe informimin cilësor të publikut.
- Publikimi i përmbajtjeve të prodhuara me Inteligjencën Artificiale nga mediat duhet të shoqërohet me sinjalizime të dukshme, për të shmangur keqkuptimet.
- Media duhet të rishikojë në mënyrë periodike politikat dhe udhëzimet për përdorimin e Inteligjencës Artificiale me qëllim përshtatjen e tyre me nevojat e audiencës dhe me zhvillimet teknologjike.
- Përdorimi i Inteligjencës Artificiale në prodhimin e përmbajtjes nuk i përjashton mediat nga detyrimi për të respektuar të drejtat e autorit. Redaksitë duhet të tregojnë kujdes që materialet e prodhuara me AI të mos përfshijnë elementë të mbrojtur nga e drejta e autorit, ose nëse i përdorin, të bëjnë referim të qartë të përmbajtjes.

2. Përdorimi i Inteligjencës Artificiale në media duhet të bëhet me mbikëqyrje njerëzore.

Asnjë sistem apo aplikacion i Inteligjencës Artificiale nuk është i pagabueshëm. Për këtë arsye, mbikëqyrja njerëzore është thelbësore për të siguruar që përmbajtja e prodhuar të jetë e saktë dhe etike. Redaktorët dhe gazetarët duhet të kenë rolin kryesor në procesin editorial, duke përdorur Inteligjencën Artificiale si mjet mbështetës dhe jo për të zëvendësuar plotësisht rolin e profesionistëve.

- Çdo informacion i prodhuar nga Inteligjenca Artificiale duhet të rishikohet dhe aprovohet nga një gazetar ose redaktor përpara publikimit.
- Gazetarët dhe redaktorët duhet të kenë aftësitë e nevojshme për të kuptuar dhe analizuar raportet dhe sugjerimet e Inteligjencës Artificiale me qëllim shmangien e gabimeve teknike apo logjike dhe të njëanshmërive të mundshme në raportim.
- Çdo raportim kritik apo investigativ i medias, që prek çështje sensitive si politika, shëndeti publik, siguria kombëtare, etj, duhet të mbështetet prej burimeve të verifikueshme nën kontrollin e një gazetari ose redaktori profesionist.
- Redaksia e medias duhet të ketë praktika të qarta për të shqyrtuar çështjet etike që lidhen me përdorimin e Inteligjencës Artificiale në përmbajtjen që i ofrojnë audiencës.
- Në rast se redaksia përdor sistemet e Inteligjencës Artificiale për të dalluar lajmet apo temat që kanë lexueshmëri më të madhe në rrjetet sociale apo në mediat online, procesi duhet të mbikëqyret nga një redaktor profesionist, i cili duhet të vlerësojë nëse tema ka të bëjë edhe me interesin publik dhe nuk ka përmbajtje dezinformuese

3. Përdorimi i Inteligjencës Artificiale duhet të jetë transparent për publikun

Transparenca është thelbësore për të ndërtuar dhe ruajtur besimin e audiencës. Kur mediat përdorin Inteligjencën Artificiale për të prodhuar ose përpunuar përmbajtje, audiencia duhet të jetë e informuar qartë për këtë fakt.

- Informacioni i prodhuar nga sistemet e Inteligjencës Artificiale duhet të identifikohet qartë për audiencat duke përdorur etiketa të tilla si: “prodhuar me ndihmën e Inteligjencës Artificiale”, “mbështetur nga IA” ose “përmbajtje e automatizuar”.
- Media duhet të sigurojë që përdorimi i Inteligjencës Artificiale të mos çojë në mashtrim ose keqinformim të audiencave.
- Media duhet të publikojë politika dhe procedura të qarta për përdorimin e Inteligjencës Artificiale, duke informuar audiencën për mënyrën dhe qëllimet e përdorimit. Këto informacione duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme për publikun e interesuar.
- Media duhet të ofrojë mekanizma për ankesat dhe pyetjet e audiencës në lidhje me përmbajtjen e prodhuar me ndihmën e Inteligjencës Artificiale. Media ka përgjegjësi të informojë audiencat për këto mekanizma.
- Me qëllim rritjen e transparencës me publikun, redaksitë, qofshin ato tradicionale dhe ato online, mund të përgatisin materiale multimediale për të shpjeguar përdorimin e Inteligjencës Artificiale në praktikën e tyre.
- Një portal lajmesh që përdor Inteligjencën Artificiale për të analizuar të dhënat e audiencës dhe për të personalizuar përmbajtjen, duhet të ofrojë një faqe me informacione ku të shpjegohet sesi funksionon ky proces dhe si përdoren të dhënat e mbledhura.

UDHËZIME TË DETAJUARA PËR PËRDORIMIN E INTELIGJENCËS ARTIFICIALE

Transparenca dhe ndjeshmëria ndaj publikut

Është thelbësore që mediat të jenë transparente në lidhje me përdorimin e Inteligjencës Artificiale në proceset e tyre editoriale. Kjo përfshin informimin e audiencës kur përmbajtja është gjeneruar ose modifikuar nga sistemet e Inteligjencës Artificiale.

Saktësia dhe verifikimi i informacionit

Pavarësisht përdorimit të teknologjisë së avancuar, përgjegjësia për saktësinë apo vërtetësinë e informacionit mbetet mbi gazetarët dhe redaktorët e lajmeve. Për këtë arsye është e domosdoshme që gjithë të dhënat e përpunuara nga Inteligjenca Artificiale të verifikohen me qëllim shmangien e informacionit të paverifikuar. Kjo përputhet me parimet e Kodit të Etikës, i cili thekson rëndësinë e saktësisë në raportim.

Ruajtja e privatësisë dhe mbrojtja e të dhënave

Mediat duhet të respektojnë privatësinë e individëve dhe të sigurojnë që përdorimi i

Inteligjencës Artificiale të mos cenojnë të dhënat personale. Përpunimi i të dhënave duhet të bëhet në përputhje me ligjet në fuqi dhe me standardet etike, duke shmangur mbledhjen ose shpërndarjen e paautorizuar të informacionit personal.

Parandalimi i njëanshmërisë dhe diskriminimit

Sistemet dhe aplikacionet e Inteligjencës Artificiale mund të reflektojnë paragjykiye të pranishme në të dhënat, të cilat përbëjnë bazën e trajnimit të tyre. Për këtë arsye është e nevojshme që media të monitorojnë dhe të korrigjojnë çdo paragjykim të mundshëm në informacionin e gjeneruar nga Inteligjenca Artificiale, duke promovuar një raportim të drejtë dhe të paanshëm.

Edukimi dhe trajnimi i stafit

Për të siguruar përdorimin etik dhe të përgjegjshëm të Inteligjencës Artificiale është e domosdoshme që gazetarët dhe stafi editorial të trajnohen në mënyrë të vazhdueshme. Programet e trajnimit duhet të kenë si synim njohjen me kapacitetet dhe kufizimet e teknologjisë, si dhe me çështjet etike që lidhen me përdorimin e saj. Trajnimi i vazhdueshëm ndihmon në integrimin e suksesshëm të inteligjencës artificiale në proceset e prodhimit dhe shpërndarjes së informacionit.

Përgjegjësia dhe llogaridhënia

Media dhe gazetarët duhet të mbajnë përgjegjësi për përmbajtjen e prodhuar me ndihmën e Inteligjencës Artificiale. Në rast të gabimeve ose keqinformimit, është detyrë e medias të korrigjojë informacionin dhe të informojë audiencën për ndryshimet e bëra, duke ruajtur transparencën dhe besueshmërinë.

Përdorimi i përgjegjshëm i Inteligjencës Artificiale në përmbajtje audiovizuale

Zhvillimi i Inteligjencës Artificiale e ka lehtësuar manipulimin e përmbajtjeve audiovizuale. Kjo ka ngritur shqetësime, veçanërisht për përmbajtjet e njohura si deepfake. Mediat duhet të jenë të kujdesshme në përdorimin e këtyre teknologjive dhe të sigurojnë që çdo modifikim i përmbajtjes të jetë transparent për audiencën, duke shmangur keqinterpretimet.

PARANDALIMI I DEZINFORMIMIT DHE UNIFORMIZIMIT TË PËRMBAJTJES

Algoritmet e Inteligjencës Artificiale mbështeten në të dhënat ekzistuese, të cilat janë lehtësisht të arritshme. Kjo gjë mund të çojë jo vetëm në përhapjen e informacionit të pasaktë apo të rremë, por edhe në uniformizimin e përmbajtjes. Mungesa e verifikimit nga profesionistët e medias rrit rrezikun e përsëritjes së informacionit të njëjtë, duke kufizuar diversitetin e perspektivave dhe analizave. Për këtë arsye, është thelbësore që gazetarët të luajnë një rol aktiv në kontrollin e fakteve dhe në pasurimin e përmbajtjes me qasje kritike dhe analitike.

REKOMANDIME

Për të garantuar një përdorim të përgjegjshëm dhe etik të Inteligjencës Artificiale në mediat shqiptare, rekomandohet që të ndërmerren hapat e mëposhtëm:

1. Të krijohen politika të qarta institucionale për përdorimin e Inteligjencës Artificiale në proceset editoriale.
2. Të zhvillohet një strukturë etike e mbikëqyrjes që përfshin ekspertë të teknologjisë dhe gazetarë.
3. Të promovohet bashkëpunimi midis institucioneve të medias dhe qeverisë për të krijuar rregullore të qarta dhe transparente.
4. Të rritet ndërgjegjësimi publik përmes fushatave të edukimit mediatic mbi avantazhet dhe rreziqet që paraqet përfshirja e Inteligjencës Artificiale në media.

Botues:



Albanian Media Institute
Instituti Shqiptar i Medias

Rr. Gjin Bue Shpata, No.8, Tiranë, Albania

Tel./fax: ++ 355 4 2229800

E-mail: info@institutumedia.org

www.institutumedia.org

Udhëzimet për Përdorimin Etik të Inteligjencës Artificiale në Median Shqiptare u hartuan nga një grup ekspertesh i përberë nga:

Erlis Cela, pedagog, ekspert i medias

Emirjon Senja, gazetar

Konsulent ndërkombëtar:

Aidan White, ish-Drejtor, Iniciativa për Gazetari Etike

Hartimi i Udhëzimeve për Përdorimin Etik të Inteligjencës Artificiale në Median Shqiptare u bë i mundur me mbështetjen e një projekti të perbashket me International Freedom of Expression Exchange (IFEX)

ifex